

VENDIM
Nr. 141, datë 8.10.2012

**PËR FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E TARIFËS SË FURNIZIMIT PUBLIK
ME SHUMICË TË ENERGJISË ELEKTRIKE NGA KESH SHA PËR PERIUDHËN E TRETË
RREGULLATORE 2012-2014, NË ZBATIM TË “METODOLOGJISË SË LLOGARITJES SË
TARIFAVE PËR FURNIZUESIN PUBLIK ME SHUMICË”**

Në mbështetje të neneve 9, 26, 27 dhe 28 të ligjit nr. 9072, datë 22.5.2003 “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar, neneve 18, 20, 21 të “Rregullave të praktikës dhe procedurave të ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 21, datë 18.3.2009, vendimit nr. 78, datë 26.6.2008 “Për miratimin e metodologjisë së llogaritjes së tarifës për furnizuesin publik me shumicë”, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (ERE), në mbledhjen e tij të datës 8.10.2012, pasi shqyrtoi aplikimin e shoqërisë KESH sh.a. për rishikimin e tarifës së furnizuesit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a., për periudhën e tretë rregullatore 2012-2014 në zbatim të “Metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë”,

VENDOSI:

1. Fillimin e procedurave për shqyrtimin e aplikimit për rishikimin e tarifës së furnizimit publik me shumicë të energjisë elektrike nga KESH sh.a. në zbatim të metodologjisë së llogaritjes së tarifave për furnizuesin publik me shumicë për periudhën e tretë rregullatore 2012–2014.

2. Ngarkohet Drejtoria Juridike dhe e Mbrotjtjes së Konsumatorit për njoftimin e KESH sh.a. në lidhje me këtë vendimmarrje.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol Ramadani